

STATISTIKA TË DIPLOMIMEVE

Viti 2024-2025

Gjatë vitit shkollor 2024-2025, në arsimin zyrtar në Shqipëri, në institucionet arsimore publike dhe jo publike, u diplomuan gjithsej 82.640 nxënës dhe studentë, të shpërndarë sipas niveleve arsimore.

- 33,5 % në arsimin 9 vjeçar;
- 31,4 % në arsimin e mesëm të lartë;
- 0,1 % në arsimin pas të mesëm jo të lartë;
- 35,0 % në arsimin e lartë.

Arsimi Parauniversitar

Gjatë vitit 2024-2025, në arsimin parauniversitar u diplomuan 53.701 nxënës, duke shënuar një rënie prej 1,5 %, krahasuar me vitin e kaluar shkollor.

- 27.682 nxënës u diplomuan në arsimin 9-vjeçar:
 - 0,1 % më pak të diplomuar, krahasuar me vitin shkollor 2023-24;
 - 47,9 % e të diplomuarve janë vajza;
 - 89,3 % janë diplomuar në institucionet arsimore publike.
- 25.925 nxënës u diplomuan në arsimin e mesëm të lartë:
 - 3,0 % më pak të diplomuar, krahasuar me vitin shkollor 2023-24;
 - 51,3 % e të diplomuarve në arsimin e mesëm të lartë janë vajza;
 - 12,3 % janë diplomuar në arsimin profesional;
 - 15,7 % e të diplomuarve në arsimin profesional janë vajza;
 - 83,9 % janë diplomuar në institucionet arsimore publike.
- 94 nxënës u diplomuan në arsimin pas të mesëm jo të lartë:
 - 31,9 % femra dhe 68,1 % meshkuj.


Arsimi Universitar

Gjatë vitit akademik 2024-2025, u diplomuan në arsimin e lartë 28.939 studentë, duke shënuar një rritje prej 2,6 %, krahasuar me një vit më parë, ku:

- 50,6 % e studentëve janë diplomuar në programin Bachelor;
- 43,4 % e studentëve janë diplomuar në programin Master;
- 65,3 % e të diplomuarve në arsimin e lartë janë femra;
- 66,6 % e studentëve janë diplomuar në institucione publike të arsimit të lartë.


Në fushën e studimit “Biznes, administrim dhe ligj” janë diplomuar rreth një e katërta e të gjithë studentëve (23,3 %), ndjekur nga fusha e dytë më e preferuar “Shëndet dhe mirëqenie” me 22,4 % dhe “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 14,0 %.

FIG. 1 TË DIPLOMUAR SIPAS GJINISË DHE NIVELEVE ARSIMORE



Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

FIG. 2 SHPËRNDARJA NË PËRQINDJE E NUMRIT TË STUDENTËVE TË DIPLOMUAR NË ARSIMIN UNIVERSITAR SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT, 2024-2025



Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara vjetore për statistikat e diplomimeve sipas niveleve arsimore dhe fushave të studimit, janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Të Diplomuar](#)

Metodologjia

Nivelet e arsimit në Shqipëri janë të organizuar sipas programeve dhe të klasifikuara sipas Klasifikimit ISCED 2011, i cili përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit, si në vijim:

Niveli 0 - Arsimi parashkollor - çerdhe/kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Koncepte

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pashkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevoja të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin, arsimin social-kulturor dhe arsimin profesional.

Arsimi profesional përfshin programet e arsimit të hartuara me qëllim përfitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave specifike për një profesion të veçantë ose klasë të profesioneve.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Burimi i të dhënave: Të dhënat e statistikave të arsimit 9 vjeçar, të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit të lartë sigurohen nga Ministria e Arsimit. Ndërsa të dhënat për arsimin profesional sigurohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me periodicitet vjetor.

Të dhënat mbi statistikën e diplomimeve janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilësia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.